

Batajnica 744 – E vërteta e varrosur

Aksioni publik, i cili organizohet me rastin e 20 vjetorit të krimit të kryer kundër civilëve shqiptarë në Kosovë, mbahet më 26 mars 2019 në Beograd, nga ora 15 deri në orën 17, duke u nisur nga Rruga e Knez Mihailova, te Çeshmja e Delisë, dhe duke përfunduar përpara Kuvendit të Republikës së Serbisë. Këtë aksion publik e organizojnë: Fondi për të Drejtën Humanitare, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut dhe Gratë në të Zeza.

Përveç faktit që ishin në rrezik nga bombardimi i NATO-së, populli civil shqiptar në Kosovë njëkohësisht i ishin nënshtruar spastrimit etnik nga regjimi i S. Millosheviqit. Njësitë e armatosura (Ministria e Punëve të Brendshme, Ushtria e Jugosllavisë dhe njësitë paramilitare) kanë kryer krime të panumëruara në Kosovë, gjë që ka arritur kulmin gjatë ndërhyrjes së NATO-së. Krimet përfshinin zhvendosjen e trupave të shqiptarëve kosovarë të vrarë në varreza masive nëpër Serbi. Para se u transportuan në Batajnicë, trupat e shqiptarëve të vrarë janë varrosur në varrezat e tyre të para masive në Kosovë. Nga viti 2001 deri sot varrezat masive janë gjetur në katër lokacione në territorin e Republikës së Serbisë me **941** trupa të shqiptarëve të vrarë në Kosovë më 1999, shumica e të cilëve janë vrarë si civilë, pa luftuar me arma. Në varrezat masive të Batajnicës kishte trupat e viktimave shqiptare të vrara në Kosovë nga 24 marsi deri më 22 maj 1999.

Sipas të dhënave nga Zyra për Persona të Pagjetur dhe Mjekësi Ligjore të UNMIK-ut, eshtrat e 744 shqiptarëve kosovarë janë gjetur në Batajnicë.

„Batajnica 744: E vërteta e varrosur”

26 mars 2019 - Aksioni publik

Një letër e bardhë me emrat e viktimave – ne, në mënyrë simbolike, po gdhendim në kujtesë kolektive diçka që mohohet dhe zvogëlohet nga shumica e shoqërisë së Serbisë - shqiptarët që u bënë viktimat e krimeve të luftës të kryera në Kosovë, të cilët pastaj fshehurazi u varrosën në varrezën masive të Batajnicës. Me këtë veprim ne po tregojmë që dimë për krimin e kryer, ne dimë kush e ka kryer krimin - ne kërkojmë të merret përgjegjësia për këtë krim.

Dheu - me të cilin do të mbulohen emrat e viktimave është një veprim i rezistencës së padhunshme ndaj fshehjes së së vërtetës për krimet e kryera në emrin tanë, ndaj betimit të heshtjes dhe harresës së organizuar të krimit. Në vend të fshirjes së gjurmave të ekzistencës së viktimave, në vend të mosballafaqimit me barrën e mizorive të së kaluarës bashkë me shtetin dhe shoqërinë tonë, ne po e zbulojmë të vërtetën për krimin, po e vëmë në dukje, po i përkujtojmë viktimat...

Shëtitje rrugëve të qytetit - në këtë mënyrë ne po i drejtohem shoqërisë sonë në të cilën jetojmë. Përmes këtij veprimi ne duam të ndajmë me bashkëqytetarët tanë dhembshuri, solidaritet dhe përgjegjësi që ndiejmë për viktimat e krimeve, për t'u munduar të ndërtojmë bashkë një sistem të ndryshëm moral, gjë që është e mundshme vetëm duke treguar qëndrueshmëri ndaj kulturës së harresës, të mohimit dhe normalizimit të krimeve, duke i hedhur poshtë gënjeshtret për krime dhe duke e ndërprerë praktikën e pandjeshmërisë dhe mospërfilljes.

Formimi i përmendores simbolike para Kuvendit – ne po u drejtohem përfaqësuesve të zgjedhur me kërkesë që t'i plotësojnë obligimet e tyre ndaj viktimave të krimeve të kryera në Kosovë, duke kontribuar në vendosjen e sundimit të ligjit, praktikën politike të dënimit të krimit dhe respektin e dinjitetit të viktimave. Ne po e paraqesim letërën me emrat e viktimave para Kuvendit - duke i nxitur deputetët që të ballafaqohen me barrën e krimeve të kryera në emrin tanë.

Beograd, 26 mars 2019